



North Green Association

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2015
- Statusi Ligjor: Organizate Jo Fitim prurëse
- Selia Qendrore: Tiranë, Shqipëri
- Faqja e Internetit: www.northgreen.org
- Email kryesor i organizatës: info@northgreen.org
- Telefoni kryesor i organizatës: +355 (0) 69 929 9369

2. Misioni

Një përmbledhje e shkurtër, 1-2 fjali, që përshkruan misionin, vlerat, ose qëllimin kryesor të organizatës.

Me misionin zhvillimin e qëndrueshëm të territorit urban dhe rural. Në bazë të saj, është përmirësimi dhe zgjidhja meanë të projekteve innovative të problematikave mjedisore, për një jetë më të shëndetshme dhe zhvillimit ekonomik social të shoqërisë.

Qëllimi

- o Studimin dhe mbrojtjen e ekosistemeve natyrore dhe rekuperimin e habitateve të jetës së egër.
- o Zhvillimin e qëndrueshëm të zonave urbane/rurale
- o Edukim dhe ndërgjegjësim për të mbrojtur dhe trashëguar mjedisin, si një e drejtë e të gjithëve

3. Vizioni (Opsionale)

Një deklaratë rreth ndikimit afatgjatë ose ndryshimit që organizata synon të arrijë. Zhvillimin e njw strukture tw qwndrueshme nw studimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

Një listë ose përshkrim i shkurtër i sektorëve ose fushave kryesore të punës së organizatës. Për shembull:

- Studime shkencore
- Mbrojtja e Mjedisit
- Zhvillimi i qëndrueshëm I territorit urban dhe rural
- Zbutja e impaktit të ndikimit në mjedis
- Advokimi për Politikë-bërje
- Sensibilizim dhe ndërgjegjësim

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Një përshkrim i shkurtër i projekteve, nismave ose programeve kryesore që organizata zhvillon ose ka zhvilluar:

- Projektet dhe bashkpunimet janë një pjesë e vecante e rritjes së eksperiencës së organizatës dhe të staffit. “Green paths for Dibra” është një projekt i financuar nga Lëviz Albania, me qëllimin ndërgjegjësimin e komunitetit të Dibrës për të mbrojtur luginën e Drinit, një mundësi e mirë zhvillimi të turizmit dhe ekonomik të zonës me anë të sporteve në natyrë
- Bashkpunime të rëndësishme me organizata (ALCDE, Federata e Pyjeve dhe Kullotave Qarku Dibër, SHERM, Delfini, Shpresa për të ardhmen) North Green ka krijuar materiale multimediale,



North Green Association

infographics dhe kërkime shkencore me fokus zhvillimin e qëndrueshëm, prerjet e pyjeve për minierat, zhvillimin e turizmit, dëmi mjedisor nga hedhja e mbeturinave.

- Kemi qenë pjesë e Kindle Advocacy zbatuar nga Co-Plan, një eksperiencë e mirë për të ritur kapacitetet e mëtejshme të organizatës, gjithashtu edhe në programin politik bërje me pjesmarrje organizuar nga Partners Albania.
- Sebashku me staffin kemi marrë pjesë cdo vit në aktivitete të përbashkëta të organizatave në shqipëri në “Ditën Kombëtare të Aktivizmit” NAD të organizuara nga Co-PLAN.
- “Campaigning for improved protection and management of forests in the protected national park of Lura” financuar nga Co-PLAN, një projekt mjaft domethënës, ku gjetjet në terren u perkthyen në një dokument për situatën e parkut. U organizuan spote advokuese dhe senbilizuese mbi shkatërimin që i është bërë pyjeve. Gjithashtu u organizua një fushatë ku u mbollën plot 1000 fidanë të llojit Hartinë. Një ndër projekte më të sukseshme.
- “Zhvillimi i turizmit në Bashkinë Prrenjas” një projekt i financuar nga programi ReLOaD, me një impakt të mirë në zhvillimin e turizmit në zonën e Bashkisë Prrenjas. Nxjerrja në pah e aseteve turistike të zonës, zhvillimin infrastrukturës turistike për tu vizituar nga kushdo dhe promovimi me anë të klipeve dha një rezultat mjaft të mirë, me rritjen e eksplorimit të zonës nga turistë vendas.
- “ËISHFULL” projekt që është implementuar nga ALCDF, në të cilin North Green Association është përgjegjëse për analizim të dhënash dhe identifikimin e modelit më të mirë në zhvillimin e turizmit.
- Dinamit Ndal, Unë jam Drini i Zi një projekt i zbatuar në zonën e Dibrës për mbrojtjen e iktiofaunës së lumit Drini i Zi nga keqbërësit të cilët peshkojnë me lëndë plasëse (Dinamit).
- Erzeni Thërret, është një projekt i zbatuar duke lartësuar zërin e ndotjes së lumit Erzen, dhe ku me anë të aktiviteteve të organizuara në terren është bërë e mundur hartëzimi i ndotjeve sipas kategorive dhe janë evidentuar pikat më të nxehta ndotëse përgjatë gjithë rrjedhës nga burimi në grykëderdhje në adriatik. Ky projekt është financuar nga Fondi për Zhvillim i Ambasadës Suedeze me anë të projektit GREEN-AL.
- SOS Fondi Kombëtar i Pyjeve është një projekt në vazhdim, ku po bashkëpunohet me institucionet vendore dhe qendrore dhe agjencitë ligjzbatuese për të bërë të mundur shtyrjen e Moratoriumit në Pyje.
- “Po Dibrës, Jo skavicës”, është një projekt ku me ndihmën e EURONATUR, duam të lartësojmë problematikën e ndërtimit të digës më të madhe në Europë, që pas shumë dekadash që është ndaluar të ndërtohen diga të lartësive të mëdha. Skavica është projekti i fundit i qeverisë shqiptare, që kërkon të ndërtojë hidrocentralin në lumin Drini i Zi. Impakti nëse do të ndërtohet një vepër e tillë me lartësi dige 144m më vëllim uji 2.7 Miliard m3, dhe një sipërfaqe mbi 60 km2 do të ketë një impakt katastrofik në të gjithë rajonin.
- 3xMirë – Për ty, Për Mjedisin, Për Komunitetin -Bashkia Kamëz. Një bashkëpunim i ndërsjellë me institucionet vendore dhe ato arsimore për një mjedis më të shëndetshëm në Bashkinë Kamëz.
- Active Eater II- Partner në zbatimin e projektit me qëllim, monitorimin e rezervuarëve kryesorë në 4 Qarqe (Tiranë, Durrës, Fier dhe Shkodër).

6. Shtrirja Gjeografike

Organizata operon në të gjithë Shqipërinë, por edhe në rajonin e Ballkanit

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Edi Truka

Bordi i Drejtuesve: Lista e anëtarëve kryesorë (nëse është e aplikueshme)



North Green Association

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

Një përmbledhje e shkurtër që thekson partnerët, donatorët ose bashkëpunëtorët kryesorë që ka patur organizata.

Donatorët kanë qenë të ndryshëm;

Co-PLAN

UNDP

Bashkia Prrenjas,

Bashkia Kamëz,

ALCDF,

Bashkimi Evropian

Lëviz Albania,

US-Embassy in Tirana

Merrimangat,

9. Ndikimi (Opsionale)

Theksoni ndonjë rezultat të matshëm, statistika, ose arritje të rëndësishme. Për shembull:

- 2457 Pjesmarrës në aktivitete të ndryshme
- 1800 Fidanë dhe 300 Pemë të mbjellura në ambiente urbane, shkolla dhe Parqe Kombëtare
- 1 Nismë në influencimin e politikave qendrore (Morratoriumi i Pyjeve)
- 18 Nisma në politika të qeverisjes vendore (të cilat kanë qenë përtej projekteve të zbatuara)
- Mbi 34 aktivitete sportive të bashkërenduara me disa nga projektet.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

Çdo zhvillim i fundit, çmime ose shfaqje në media për organizatën.

Disa nga projektet kanë patur dalje edhe në media kombëtare dhe locale. Top-channel, Euroneës, TVSH por edhe në radiot të ndryshe.

-